



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Dana

28 - 12 - 2018



REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:053832

Datë: 08.11.2018

Numri i dokumentit: 00173049

P.nr.761/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal. si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], që të dy me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj, me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP//II.nr.1081-7/16 të dt.27.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.08.11.2018 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. I akuzuari [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], martuar, prind i një fëmije, punon privat, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri, me numër personal [REDACTED].

2. I akuzuari [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED].

JANË FAJTOR

Sepse:

- me datën 26.05.2016 rreth orës 18:30, në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomiko pyjor Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur “ Te barakat- Lugi i Dardhës ”, në bashkëveprim me qëllim vjedhje me sharrë motorike kanë prerë 4 copë trungje të llojit ahu, me dimensione të gjata boniteti III m, me diametër 21-47 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 2.93 metra kubë, të cilat kanë transportuar me traktor të tipit “Ferguson 39 ”, vlera e demit të shkaktuar është 397,89 Euro-,

- me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje pylli nga nen 358 par 1 të KPK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nen. 4,7, 8, 9, 17, 41, 43,46, 49, 50, 51, dhe 73 të KPRK-së dhe nen. 365 të KPPRK-së të akuzuarit i,

GJYKON

I. Të akuzuarit [REDAKTUE], i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 100 /njëqind / euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 15, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari [REDAKTUE] të paguaj shpenzimet e procedurës penale- paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimtit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të akuzuarin [REDAKTUE] i caktohet dënnimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari [REDAKTUE] të paguaj shpenzimet e procedurës penale- paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimtit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen të akuzuarit [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE], që në mënyrë solidare të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 397,89 Euro-, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1081-7/16 të dt.27.03.2017, i ka ngarkuar të akuzuarit, [REDACTED] dhe [REDACTED], që të dy me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rrëth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me datën 13.11.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED]

Në fillim të shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarve janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarve dhe pasi që gjyqtari është bindur se të njëjtët e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën janë akuzuar, të njëjtëve i kanë dhënë mundësi të deklarohen mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është e vërtet se ka shkuar në pyllin shoqëror për të marrë dru për nevoja të familjes e jo për shitje e për shkak të gjendjes ekonomike që kushte të dobët nuk ka pasur mundësi që ti blej drutë, tanë është martuar, dhe ka fillu të punoj privat i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merr përbazë theksimet e cekura në seancën e sotme gjyqësore.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar se është e vërtet se atë ditë e ka ftuar [REDACTED] që të shkoj dhe ti ndihmoj për të shkuar dhe marrë dru në pyll për nevoja të familje i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merr përbazë theksimet e cekura në seancën e sotme gjyqësore.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, ka dekluarar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjt dhe ka mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se të akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtar se të akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë në fletëparaqitjen re rojtarit të pyllit të drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj me nr.238/2016 i dt.15.06.2016, procesverbalin i rojës së pyllit për vlerësimin e dëmit, me numër dhe datë të njëjtë e nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Meqenëse të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjiths elementet e veprës penale me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi veç e veç sanksionet penale dhe atë për [REDACTED], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind / €uro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 15, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe [REDACTED] i caktohet dënimini me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, pra si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.


Obligohen të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED], që të dëmtuarës Drejtoria për Zhvillim Ekonomik-Zyra në Ferizaj, në mënyrë solidare t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 397,89 €uro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimate të krimtit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.761/17 me datë 08.11.2018

Zyrtarja ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.